



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. 1188 prot.

Tiranë, më 21.06.2024

Lënda: Kthim përgjigje.

Drejtuar:

Për Dijeni:

Në përgjigje të kërkesës Suaj me Nr.27 Prot, datë 13.06.2024, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) me Nr. 1188, datë 14.06.2024, “Kërkesë për testim të tre transformatorëve të rrymës në terren”, Ju bëjmë me dije se:

Bazuar në VKM nr.1351, datë 3.10.2008, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara” dhe VKM nr. 770, datë 2.11.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, instrumenti të cilit Ju i referoheni në shkresën Suaj “transformator të rrymës” nuk është pjesë e kësaj rregullore dhe DPM nuk ofron shërbim për të.

Gjithashtu në asnjë akt ligjor që lidhet me Metrologjinë (Ligje, VKM apo Urdhër) nuk gjendet asnjë përcaktim apo kërkesë që lidhet me transformatorët matës, për këtë arsye nuk përfshihet në shërbimet që kryen apo që mund të autorizoj Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Petrit Rama

